

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dokumenti zbardh takimin sekret në Hagë/ Jack Smith i shpallte të dënuar me burgim të përjetshëm ish-krerët e UÇK-së që në vitin 2020
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/dokumenti-zbardh-takimin-sekret-ne-hage-jack-smith-i-shpallte-te-denuar-m-i105033
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 18:06:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 17:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b4c6a6fa43473dc708199fbf2fffd64b661e747be5a8540621396b92a53298b0
TEKSTI	bd26e3ac740592f7855556a59e4d7293c5ba85aea84a2bc164589941ab7aa0d8
PAMJA	80449196fc42d7ae0ae5d3cc3c6d7aa2e2de05e150ba17cbc80e240cdc54cb0e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f5efe195f0887927faa4ab2ebe94767154f6a8a1d196ce6dbbe9f49826b6b814
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e6de1b535956bbc0d3f1977997734a5d8ef6212b247caf423164a2e3e3b2297a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f5efe195f0887927faa4ab2ebe94767154f6a8a1d196ce6dbbe9f49826b6b814>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [se Piranjava](#) bijes se [Simeone](#) [Asgje](#) [rezikshme](#) [tiniandezëve](#) [e ven](#)
[prek](#) [dëshmorit](#) [përballë](#) [nuk e](#) [të vendit,](#) [opozites](#) [të](#) [ka bërë](#) [ven](#)
[personazhet](#) [te UÇK-](#) [duke](#) [nxin](#) [në rrjetin](#) [është edhe](#) [përfaqitën](#) [qytetarëve](#) [të](#)

KOSOVA

Dokumenti zbardh takimin sekret në Hagë/ Jack Smith i shpallte të dënuar me burgim të përjetshëm ish-krerët e UÇK-së që në vitin 2020

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 19:48



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimit mund të jetë paracaktuar që në fillimet e procesit gjyqësor në Hagë.

Këtë përshtypje e përforcon një dokument, i cili zbardh prapaskenat e një takimi të mbajtur më 7 dhe 8 dhjetor 2020, vetëm një muaj pas arrestimit të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në seancën informuese të mbajtur larg syrit të opinionit publik dhe pa asnjë komunikatë zyrtare, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, bashkë me ish-Kryeprokurorin e Specializuar Jack Smith dhe Regjistruesen Fidelma Donlon, u takuan me ambasadorë e diplomatë të akredituar në Kosovë, ndërsa takime të ngjashme u zhvilluan edhe në Hagë e Beograd.

Gjatë këtij takimi 'sekret', ish-Kryeprokurori Jack Smith u shpreh me një gjuhë të ashpër dhe të prerë, duke deklaruar me bindje të plotë se të akuzuarit do të dënohen me burgim të përjetshëm. Sipas dokumentit të publikuar nga Klan Tv, Smith pretendon se aktakuza e tij mbështetet në çdo fjalë të provat e dëshmitarët për "qindra viktima të torturuara e të vrara në qendrat e ndalimit", ndërsa denoncoi atë që e quajti "përpjekje të Thaçit dhe Veselit për të penguar punën e Prokurorisë".

Ai u kërkoi diplomatëve mbështetje publike, dërgimin e personelit shtesë hetimor. Rrethanat rëndohen pasi Kryetarja e Gjykatës, Ekaterina Trendafilova, e pranishme në takim, nuk bëri asnjë reagim ndaj deklarave të Smithit, që cenonin rëndë parimin e prezumimit të pafajësisë.

Nga ana e saj, Trendafilova bëri një përmbledhje të zanafillës së gjykatës nga libri i Carla del Ponte-s, raporti i Dick Marty-t dhe gjetjet e Ekipit Hetimor Special (SITF), duke sqaruar se selia ndodhet jashtë Kosovës për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe se ndjekja penale lidhet vetëm me përgjegjësinë individuale e jo me UÇK-në si organizatë apo ushtri.

E pyetur nga Ambasadori Gjerman përse në sallën e gjyqit nuk shfaqen flamuri dhe simbolet shtetërore të Kosovës – çështje e ngritur edhe nga mbrojtja e Thaçit – Trendafilova u përgjigj se institucioni financohet nga BE-ja e donatorët dhe përbëhet nga profesionistë ndërkombëtarë. Ajo e cilësoi ngritjen e kësaj teme nga avokatët si një provokim me qëllim të pastër politik për të krijuar debat në Kosovë e për të delegitimuar Dhomat e Specializuara.

Ndërsa, në fjalën e saj Regjistruesja Fidelma Donlon garantoi se "institucioni zbaton standardet më të larta ndërkombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe garantimin e të drejtave të të akuzuarve".

Kujtojmë se ish-krerët e UÇK-së u dënuan nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg në total. Hashim Thaçi u dënua me 25 vite burg, Jakup Krasniqi me 25 vite, Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vite burg. Vendimi u prit me indinjatë nga shqiptarët, që nënvizojnë se krerët e UÇK-së luftuan për lirinë e Kosovës. Vendimi është i shkallës së parë dhe do apelohej.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 19 Shtator17:09

[Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë tjetër protestë: Lironi çlirimtarët](#)

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pritet të protestojë sërish javë e mëtej.

KOSOVA 19 Shtator16:12

[Konfirmohen 7 rasta me virusin e Nilit Barëndimor në Kosovë, pasqyrtrohen dy viktima](#)

[ASHTUJENDE / AMBASA E SHBA-SË PARALAJMËRON SE PROTESTAT E SHQIPTARËVE NË PRISHTINË MUND TË PËRSHKALLËZOHEN](#)

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka njoftuar se dy persona kanë humbur jetën nga virusi i Nilit Per&...

KOSOVA 19 Shtator15:12

[Identifikohen 3 viktime nga varret masive në Zubin Potok/ Kurti: Mbetjet mortore u përkasin “Grupit të Intelektualëve”](#)

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë të ditur në nisje të vizitës së tij zyrtare në Shtetet e Bashkuara t...

KOSOVA 19 Shtator11:17

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ A rrezikon destabilizim Kosova? Eksperti: Serbia goditi më shumë SHBA-të! Ndërhyri te vendimi i Hagës](#)

Vendimi i Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së pritet të ketë pasoja edhe përtej pr...

KOSOVA 18 Shtator22:57

[Specialja zbardh rrugën e Apelit, 30 ditë për hapin e parë](#)

Me shpalljen e aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, beteja ligjore nuk përfundon. Tash, radha ës...

KOSOVA 18 Shtator22:29

[Djali i Jakup Krasniqit: Kur të përfundojë dënimin, babai mund të mos jetë gjallë](#)

Altin Krasniqi ka folur për dënimin 25-vjeçar të babait të tij, Jakup Krasniqit, nga Gjykata Speciale në Hagë, duke e cil&e...

KOSOVA 18 Shtator22:01

[Gruaja simbol e eksodit të Kosovës: UÇK-ja na ndihmoi të shpëtonim](#)

Sherife Luta, gruaja që u bë simbol i eksodit të shqiptarëve të Kosovës gjatë luftës, ka rrëfyer përjetimet e ...

KOSOVA 18 Shtator21:30

[Për të tretën natë me radhë, qytetarët mbledhen në shesh kundër vendimit të Speciales](#)

Për të tretën natë me radhë, qytetarë të shumtë janë mbledhur në sheshin “Skënderbeu” në...

KOSOVA 18 Shtator21:13

[Ambasada e SHBA-së paralajmëron se protestat në Prishtinë mund të përshkallëzohen](#)

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë ka paralajmëruar qytetarët për vazhdimin e protestave në kryeqytet, duke u b&eu...

KOSOVA 18 Shtator17:42

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: S’e besoj se Thaçi është përfshirë në vepra të paligjshme](#)

Ish-i dërguari i SHBA-ve në Kosovë Christopher Hill ka komentuar dënimin me 81 vite burg për ish-krerët e Ushtrisë Çli...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 18 Shtator

[VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...](#)

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

AKTUALITET 19 Shtator

[Të shtëna me armë në një kantier ndërtimi në Ti...](#)

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar në orët e para të mëngjesit në një kantier ndërtimi në T...

AKTUALITET 18 Shtator

[Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas...](#)

Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës](#)

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.